

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Drejtimin Mësimor

**“KËRKIM, SHPIM DHE SHFRYTËZIM
NAFTE, GAZI DHE UJI”**

**Niveli IV i KSHK
(1 vjeçar)**

Kodi: X-IV-21

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2021

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i Kornizës Shqiptare të Kualifikimit (KSHK).**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i KSHK.**
 1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i KSHK.
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i KSHK.
 3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i KSHK.
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i KSHK.
- III. Plani mësimor për drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i KSHK.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për çertifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i KSHK.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i KSHK.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i KSHK, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me sektorin e shpimit të puseve dhe nxjerrjes së naftës dhe gazit si dhe për të vijuar arsimin dhe formimin në nivele më të larta”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt formimit profesional dhe arsimit të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse dhe menaxhuese, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale dhe akademike;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në një nga profilet e nivelit III të KSHK të drejtimit mësimor “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- në rastet kur kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi

dhe uji”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efikente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse e menaxhuese për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll dhe përshtatshmëri gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në njërin nga profilet mësimore të nivelit III të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të hartojë një plan-bisnesi që lidhet me veprimtaritë profesionale përkatëse;
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacion që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse;
- Të zbatojë standardet teknike të profesionit përkatës;
- Të interpretojë standardet, kërkesat dhe zbatimin e legjislacionit në sektorin e shpimit të puseve dhe nxjerrjes së naftës dhe gazit;
- Të zbatojë kërkesat teknologjike të parashikuara në projektet e shpimit të puseve dhe nxjerrjes së naftës dhe gazit;
- Të organizojë bashkërendimin e të dhënave gjeologjike me ato inxhinierike;
- Të përzgjedhë pajisjet e ndryshme që përdoren në sondën e shpimit (pus);
- Të zbatojë kërkesat e sigurimit teknik të çdo vendi pune të ekipit (brigadës) në sondë (ndriçim, pastërti, hapësirë etj.);
- Të zbatojë kërkesat për mbrojtjen e mjedisit;
- Të komunikojë me etikë profesionale.
- Të vizatojë format e trajektoreve të puseve të orientuar;
- Të specifikojë tipet e ndryshme të pajisjes së fundit të kolonës së shpimit gjatë shpimit të puseve të orientuar deri në horizontalë;
- Të dallojë veçoritë e shpimit të puseve në det;
- Të zbatojë procedurat për provën e shtresës prodhimore dhe përvetësimin e pusit;
- Të kryejë kompletimin e pusit për vënien në shfrytëzim të tij;

- Të kryejë vendosjen e pakerit (taposësit të brendshëm) të kolonës;
- Të hartojë procedurat për braktisjen (abandonimin) e pusit;
- Të plotësojë dokumentacionin përfundimtar të pusit;
- Të përzgjedhë mënyrat e shfrytëzimit të vendburimeve të naftës;
- Të organizojë të gjithë kapacitetet për të bërë të mundur rritjen e koeficientit të naftënxjerrjes me një shfrytëzim optimal të vendburimit;
- Të ruajë e të mirëmbajë librin (biografinë) e pusit nga fillimi i procesit të shpimit deri në përfundim të shfrytëzimit të pusit. (deri kur abandonohet apo kalon në ruajtje);
- Të parashikojë mundësitë që ofron tregu i punës për kualifikime të mëtejshme;
- Të aplikojë metodat e vlerësimit dhe vetëvlerësimit të aftësive profesionale;
- Të përcaktojë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit;
- Të aplikojë mjetet e nevojshme për sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit, për të realizuar vendim-marrje në biznes;
- Të aplikojë elementët e përcaktimit të çmimit;
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të punës, me theks të veçantë në të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe të punëmarrësit;
- Të hartojë dokumentacionin teknik dhe ekonomiko-financiar në shpimin e puseve dhe në nxjerrjen e naftës dhe gazit;
- Të zbatojë rregullat e trajtimit dhe të ruajtjes së dokumentacionit.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i KSHK.

Ky kualifikim i jep nxënësit mundësinë që t'i drejtohet tregut të punës për punësim në ndërmarrje të ndryshme private/shtetërore që ushtrojnë aktivitet në fushën e kërkimit, shpimit dhe shfrytëzimit të naftës, gazit dhe ujit. Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e kërkimit, shpimit dhe shfrytëzimit të naftës, gazit dhe ujit në profesionet: teknik gjeolog, teknik shpimi, teknik shfrytëzimi etj. Po ashtu, në varësi të profilit ai mund të punësohet në një biznes që operon në fushën e kërkimit, shpimit dhe shfrytëzimit të naftës, gazit dhe ujit, në sektorët e prodhimit dhe të mirëmbajtjes etj.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i KSHK, e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale dhe me Çertifikatën e përfundimit të këtij niveli që përkon me nivelin profesional Teknik/Menaxher në këtë fushë profesionale, të njohur në territorin e Republikës së Shqipërisë me mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin pas të mesëm, ose në nivelin e studimeve universitare.

**III. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin mësimor
“Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i KSHK.**

Plani mësimor për drejtimin “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, niveli IV i KSHK.			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/ vjetore
			Klasa 13
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	15/16 (480/512)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		Fizikë	1
7		Biologji	2
8		Shkenca sociale	1
9		Histori	1
10		Gjeografi	1
11		TIK	1
12		Edukim fizik, sporte, shëndet	2
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	9 (288)
1	L-17-197-20	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-05-198-12	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	1
3	L-35-506-19	Menaxhimi, legjislacioni dhe siguria në punë në industrinë e naftës	2
4	L-35-507-19	Shpimi i puseve	2
5	L-35-508-19	Shfrytëzimi i vendburimeve të naftës dhe gazit	2
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	6 (192)
1	M-35-1572-20	Montimi i sondës së shpimit	48
2	M-35-1573-20	Mbikqyrja e procesit të shpimit të pusit	48
3	M-35-1574-20	Organizimi i proceseve të nxjerrjes së naftës dhe gazit	48
4	M-35-1575-20	Drejtimi i operacioneve të grumbullimit dhe transportit të naftës dhe gazit	48
		Gjithsej A+B+C	30/31 (960/992)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (32 javë mësimore + 4 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin “*Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji*”, niveli IV i KSHK, përbëhet nga 3 grupe elementësh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave profesionale dhe menaxheriale, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i personelit mësimdhënës e drejtues të shkollës. Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit mësimor “*Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji*”, niveli IV i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi. Rekomandohet përdorimi i metodës së “*lojës me role*”, ku nxënësve tu jepen përgjegjësi në kryerjen e funksioneve menaxhuese dhe drejtuese.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional “*Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji*”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet përfundimtare.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në drejtimin mësimor “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim naftë, gaz dhe uji”, niveli IV i KSHK, i nënshtrohet provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale (sipas udhëzimeve të MASR dhe MFE) si dhe Provimit të Praktikës Profesionale të Integruar (sipas udhëzimeve të MFE).

VII. Të dhëna për çertifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim naftë, gaz dhe uji”, niveli IV i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim naftë, gaz dhe uji”, niveli IV i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Çertifikatën e Teknikut në kërkim, shpim dhe shfrytëzim naftë gaz dhe uji, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modeleve të miratuara nga MASR dhe MFE, këto dëshmi përmbajnë:

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:

- rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale të klasës 13-të;

- rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale dhe të Praktikës Profesionale të Integruar.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-197-20). Kl. 13 – 64 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- të analizojnë veçoritë e etikës dhe komunikimit në kontekstin e veprimtarisë së bizneseve
- të bëjnë vlerësimin e mundësive dhe rreziqeve në kontekstin e konceptimit të idesë së biznesit
- të përshkruajnë rëndësinë dhe strukturën e një plani biznesi
- të zbatojnë procedurat e regjistrimit dhe përshkruajnë fazat e zhvillimit të biznesit
- të konceptojnë strukturën organizative dhe përshkrimet e punës së personelit të një biznesi
- të përshkruajnë veçoritë e planifikimit, rekrutimit, seleksionimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore të një biznesi
- të analizojnë aspektet e buxhetimit të një biznesi
- të kryejnë llogaritje ekonomike në kuadrin e kontabilitetit financiar të një biznesi
- të llogarisin kostot dhe çmimet e produkteve e shërbimeve të një biznesi
- të analizojnë aspektet e marketingut dhe teknikat e shitjeve në një biznes
- të analizojnë rolin dhe teknikat e e-sipërmarrjes në veprimtarinë e bizneseve.
- të përshkruajnë dhe simulojnë veprimet individuale me bankat, në lidhje me llogaritë, transfertat, kreditë dhe investimet.
- të analizojnë llojet e siguracioneve personale dhe veprimet që kryhen me to.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 64 orë

Tema 1	Etika dhe komunikimi në biznes	4 orë
Tema 2	Konceptimi i idesë së biznesit, vlerësimi i mundësive dhe rreziqeve	6 orë
Tema 3	Hartimi i planit të biznesit	6 orë
Tema 4	Procedurat e regjistrimit të biznesit	6 orë
Tema 5	Struktura organizative dhe personeli i biznesit	5 orë
Tema 6	Planifikimi, rekrutimi, seleksionimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore	6 orë
Tema 7	Kostimi dhe çmimi i produkteve dhe shërbimeve	4 orë
Tema 8	Kontabiliteti financiar në kuadrin e biznesit	6 orë
Tema 9	Buxhetimi në biznes	4 orë
Tema 10	Marketingu dhe shitjet në biznes	9 orë
Tema 11	E – sipërmarrja	2 orë
Tema 12	Veprimet individuale me bankat	3 orë
Tema 13	Siguracionet personale	3 orë

2. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-12). Kl. 13 – 32 orë

- **Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin për “mjedisin” dhe “mbrojtjen e mjedisit”.
- Të shpjegojnë kuptimin për “zhvillimin e qëndrueshëm”
- Të tregojnë se si ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues.
- Të përshkruajnë burimet kryesore të mjedisit jetësor.
- Të analizojnë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor.
- Të tregojnë dhe të japin shembuj të ndikimit të mbetjeve në mjedisin jetësor.
- Të përshkruajnë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- Të përshkruajnë sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- Të hulumtojnë dhe analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- Të planifikojnë dhe realizojnë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13 - 32 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithshme për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
Tema 2	Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë
Tema 3	Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis	3 orë
Tema 4	Zhvillimet demografike dhe mjedisi	3 orë
Tema 5	Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë
Tema 6	Monitorimi i burimeve mjedisore	3 orë
Tema 7	Kuadri ligjor dhe institucional për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm	2 orë
Tema 8	Sistemet e menaxhimit të mjedisit	3 orë
Tema 9	Veprimtari praktike për analizën e problemeve dhe planifikimin e nismave mjedisore në nivel lokal	3 orë
Tema 10	Veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit lokal	6 orë

3. Lënda “Menaxhimi, legjislacioni dhe siguria në punë në industrinë e naftës” (L-35-506-19). Kl. 13–64 orë

- **Synimet e lëndës “Menaxhimi, legjislacioni dhe siguria në punë në industrinë e naftës”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Menaxhimi, legjislacioni dhe siguria në punë në industrinë e naftës”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të analizojë elementët (komponentët) e hartimit të një buxheti për një sipërmarrje të vogël;
- Të zbatojë fazat e menaxhimit të një projekti (duke identifikuar burimet e nevojshme për një projekt të veçantë);
- Të përdorë teknika mbështetëse për të menaxhuar dhe zbatuar një projekt në situata të

ndryshme;

- Të përdorë metoda të zgjidhjes së problemeve në kontekste të ndryshme;
- Të parashikojë mundësitë që ofron tregu i punës për kualifikime të mëtejshme;
- Të analizojë konceptin e ndërmarrjeve me përgjegjësi sociale në kontekste lokale dhe globale;
- Të aplikojë metodat e vlerësimit dhe vetëvlerësimin të aftësive profesionale;
- Të përcaktojë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit;
- Të analizojë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit), duke u përqendruar në mënyrën e drejtimit, integritit, motivimit dhe mbikëqyrjes së tyre;
- Të aplikojë mjetet e nevojshme për sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit, për të realizuar vendim-marrje në biznes;
- Të vlerësojë dobinë e marketingut në biznes;
- Të zbatojë kuadrin ligjor dhe detyrimet administrative në biznes;
- Të përdorë elementët e përgjithshme të përcaktimit të kostos;
- Të zbatojë konceptin e normimit të punës në përgjithësi, kohët kryesore dhe ndihmëse të punës në makineri ose pajisje;
- Të aplikojë elementët e përcaktimit të çmimit;
- Të analizojë çmimet e materialeve kryesore dhe atyre ndihmëse që përdoren në fushën e naftës dhe gazit, sipas veçorisë së tyre për mënyrën e furnizimit, afatin dhe ciklin e përdorimit, volumin dhe mënyrën e magazinimit të tyre etj.;
- Të analizojë mënyrat e planifikimit të aktivitetit prodhues;
- Të analizojë Mbijetesën, Konkurrencën, Mundësitë dhe Lulëzimin e ndërmarrjes;
- Të analizojë planin operacional dhe buxhetin e njësisë ku punon;
- Të analizojë mënyrën e organizimit dhe mbikëqyrjes së punës për drejtimin/menaxhimin e njësisë të prodhimit si, ndërmarrje, sektorë, reparte, linja prodhimi, brigadë, etj.;
- Të hartojë urdhrat e punës;
- Të hartojë organizimin e procesit të prodhimit, sipas posteve të punës, deri në magazinimin e prodhimit të gatshëm;
- Të përcaktojë rezervën e nevojshme materiale (lëndë të para, ndihmëse, etj.), për të mos penguar procesin e prodhimit;
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të punës, me theks të veçantë në të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe të punëmarrësit;
- Të zbatojë legjislacionin për kontrata e shërbimit dhe nënshërbimit (nënkontratat);
- Të zbatojë pjesë të plan-vendosjes të njësisë të prodhimeve, (skemat e furnizimit të energjisë, të ujit, të telekomunikacionit, skemat e sistemit të sigurisë dhe mbrojtjes nga zjarri, të shkarkimeve të ujërave e të gazrave, të mbetjeve të ngurta);
- Të hartojë dokumentacionin teknik në shpimin e puseve dhe në nxjerrjen e naftës dhe gazit;
- Të hartojë dokumentacionin ekonomiko-financiar në shpimin e puseve dhe në nxjerrjen e naftës dhe gazit;

- Të zbatojë rregullat e trajtimit dhe të ruajtjes së dokumentacionit;
 - Të përzgjedhë komponentët përbërës të uniformës dhe pajisjeve mbrojtëse personale VPMP;
 - Të kontrollojë kushtet dhe funksionimin e uniformës dhe pajisjeve mbrojtëse personale VPMP;
 - Të organizojë praktikat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
 - Të vendosë shenjat, tabelat paralajmëruese dhe shiritat për sigurimin e sheshit të pusit apo të zonës ku kryhen punime;
 - Të demonstrojë procedurat e ndihmës së shpejtë;
 - Të analizojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë gjatë montimit të sondës së shpimit dhe pajisjeve të saj;
 - Të analizojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të shpimit;
 - Të analizojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të qarkullimit të lëngut larës;
 - Të analizojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të tubimit të pusit dhe të çimentimit të kolonave të rrethimit;
 - Të analizojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë përgatitjes dhe përpunimit kimik të lëngut larës;
 - Të vlerësojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë manifestimit të shenjave dhe informacionit për prishje të ekuilibrit hidrodinamik të presioneve shtresë-pus;
 - Të analizojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të shërbimeve mirëmbajtëse të sondës së shpimit;
 - Të analizojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të likuidimit të avarive;
 - Të vlerësojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë fontanave të hapura të naftës dhe gazit;
 - Të vlerësojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të përvetësimit të pusit;
 - Të analizojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të shfrytëzimit të pusit;
 - Të parashikojë rreziqet potenciale të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të braktisjes (abandonimit) së pusit;
- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Menaxhimi, legjislacioni dhe siguria në punë në industrinë e naftës”, kl. 13 - 64 orë**

Tema 1	Komponentët e hartimit të një buxheti për një sipërmarrje të vogël	3 orë
Tema 2	Fazat e menaxhimit të një projekti	3 orë
Tema 3	Ndërmarrjet me përgjegjësi sociale në kontekste lokale dhe globale	2 orë
Tema 4	Metodat e vlerësimit dhe vetëvlerësimit të aftësive profesionale	2 orë

Tema 5	Lidhja dhe ndryshimi midis sipërmarrjes dhe menaxhimit	2 orë
Tema 6	Menaxhimi i burimeve njerëzore	3 orë
Tema 7	Vendim -marrja në biznes	3 orë
Tema 8	Marketingu në biznes	3 orë
Tema 9	Legjislacioni dhe detyrimet administrative në biznes	4 orë
Tema 10	Elementët e përgjithshme të përcaktimit të kostos	3 orë
Tema 11	Normimi i punës	3 orë
Tema 12	Elementët e përcaktimit të çmimit	3 orë
Tema 13	Çmimet e materialeve kryesore dhe atyre ndihmëse	3 orë
Tema 14	Planifikimi i aktivitetit prodhues	2 orë
Tema 15	Konkurrenca	2 orë
Tema 16	Plani operacional dhe buxheti i njësisë	2 orë
Tema 17	Drejtimi/menaxhimi i njësive të prodhimit	3 orë
Tema 18	Legjislacioni shqiptar i punës	4 orë
Tema 19	Të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe të punëmarrësit;	3 orë
Tema 20	Legjislacioni për kontratat e shërbimit dhe nënshërbimit (nënkontratat)	3 orë
Tema 21	Dokumentacioni teknik në shpimin e puseve dhe në nxjerrjen e naftës dhe gazit	3 orë
Tema 22	Dokumentacioni ekonomik-financiar në shpimin e puseve dhe në nxjerrjen e naftës dhe gazit;	3 orë
Tema 23	Trajtimi dhe të ruajtja e dokumentacionit	2 orë

4. Lënda “Shpimi i puseve” (L-35-507-19). Kl. 13 – 64 orë

- **Synimet e lëndës “Shpimi puseve”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Shpimi i puseve”, kl. 13, nxënësi duhet:

- Të dallojë vendndodhjen e pikës së shpimit (sondës);
- Të interpretojë rezultatet gjeologjike gjatë shpimit të puseve;
- Të vlerësojë treguesit dhe rreziqet gjeologjike gjatë shpimit të puseve dhe vënies në shfrytëzim të tyre;
- Të bashkërendojë të dhënat gjeologjike me ato inxhinierike;
- Të interpretojë projektin (programin) e shpimit të pusit;
- Të komunikojë (brigadës) instruksione për procesin e montimit të sondës (kullës dhe gjithë pajisjeve të tjera) në pus;
- Të përzgjedhë pajisjet e ndryshme që përdoren në sondën e shpimit (pus);
- Të mbështesë punimet elektrike në sondë dhe rreth saj (sipërfaqen e zyrave);
- Të përcaktojë funksionet, montimin dhe saldimin e linjave të pjesës sipërfaqësore të sistemit të qarkullimit të lëngut larës në pus;
- Të specifikojë karakteristikat teknike të sistemit të qarkullimit të sondës;
- Të specifikojë karakteristikat teknike të sistemit të prodhimit të energjisë së sondës (motorëve);
- Të analizojë rezultatet e procedurave të kolaudimit të sondës përfshirë të gjitha pajisjet dhe nyjet e saj përbërëse;

- Të rishikojë kushtet e sigurimit teknik të çdo vendi pune të ekipit (brigadës) në sondë (ndriçim, pastërti, hapësirë etj.);
- Të zbatojë lejën që merret për shpimin e një pusi;
- Të vlerësojë faktorët që ndikojnë në ekuilibrin e presioneve midis pusit dhe shtresës duke përfshirë edhe presionet suplementare;
- Të demonstrojë procedurat e procesit të pastrimit të lëngut larës nga shllami;
- Të llogarisë humbjet hidraulike të lëngut larës në sistemin e qarkullimit;
- Të zbatojë procedurat për optimizimin e energjisë hidraulike dhe larjen e pusit;
- Të specifikojë fushat e përdorimit të puseve të orientuar deri në horizontalë;
- Të vizatojë format e trajektoreve të puseve të orientuar;
- Të dallojë veçoritë e teknologjisë për shpimin e puseve të orientuar deri në horizontalë;
- Të specifikojë tipet e ndryshme të pajisjes së fundit të kolonës së shpimit gjatë shpimit të puseve të orientuar deri në horizontalë;
- Të dallojë veçoritë e shpimit të puseve në det;
- Të specifikojë veçoritë e shpimit për shfrytëzimin e ujërave nëntokësorë;
- Të demonstrojë veprimet për aplikimin e regjimit të shpimit;
- Të ndjekë procesin e ecurisë së shpimit në tërësi gjatë thellimit të pusit dhe manovrave të ndryshme të tij;
- Të hartojë masat për parandalimin e ndërlikimeve dhe avarive gjatë procesit të shpimit të pusit;
- Të organizojë procesin e çimentimit të kolonave të rrethimit në pus si dhe të tapave të çimentos dhe tamponimeve;
- Të komunikojë me inxhinierin për ecurinë e procesit të çimentimit (normalitetin apo parregullsitë e rastit);
- Të ndër marrë veprimet korrigjuese për gjendje të parregullta;
- Të zbatojë procedurat për provën e shtresës prodhimtare dhe përvetësimin e pusit;
- Të interpretojë grafikët e provës së shtresës;
- Të mbështesë heqjen (largimin) e lëngut larës të përdorur që ndodhet në rezervuarët e pusit dhe mbushjen e tyre me lëng larës të freskët ose ujë;
- Të kryejë kompletimin e pusit për vënien në shfrytëzim të tij;
- Të vendosë filtrin në kolonën e shfrytëzimit të pusit;
- Të kryejë vendosjen e pakerit (taposësit të brendshëm) të kolonës;
- Të vlerësojë demontimin e sondës së shpimit;

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Shpimi i puseve” klasa 13- 64 orë**

Tema 1	Gjeologjia dhe litologjia e prerjes ku kalon pusi	3 orë
Tema 2	Komplikacionet teknologjike të prerjes gjeologjike	3 orë
Tema 3	Projekti i shpimit të një pusi	4 orë
Tema 4	Montimi i sondës së shpimit	3 orë
Tema 5	Agregatët e fuqisë në sondën e shpimit	2 orë
Tema 6	Sistemi i qarkullimit dhe pastrimit të lëngut larës	3 orë
Tema 7	Infrastruktura e sigurimit teknik në sondë	2 orë
Tema 8	Hermetizimi i grykës së pusit. Preventorët	2 orë
Tema 9	Kolaudimi i sondës së shpimit	2 orë
Tema 10	Humbjet hidraulike gjatë qarkullimit të lëngut larës në pus	3 orë
Tema 11	Ekuilibri i presioneve në pus me presionin e shtresës	3 orë

Tema 12	Larja e pusit dhe optimizimi i hidraulikës së shpimit	3 orë
Tema 13	Shpimi i puseve të orientuar dhe horizontalë	4 orë
Tema 14	Shpimi i puseve në det	4 orë
Tema 15	Shpimi i puseve për shfrytëzimin e ujërave nëntokësorë	3 orë
Tema 16	Zbatimi i regjimit të shpimit. Optimizimi i regjimit gjatë shpimit të pusit	3 orë
Tema 17	Parandalimi i ndërlikimeve dhe avarive gjatë shpimit të pusit	2 orë
Tema 18	Çimentimi i kollonave të rrethimit, tapat e çimentos dhe tamponimet	5 orë
Tema 19	Prova e shtresës prodhimore dhe përvetësimi i pusit;	4 orë
Tema 20	Kompletimi i pusit për vënien në shfrytëzim	2 orë
Tema 21	Demontimi i sondës së shpimit	2 orë
Tema 22	Kompletimi i trungut të pusit dhe grykës së pusit në rastet e lënies së pusit në konservim. Braktisja e pusit	2 orë

5. Lënda “Shfrytëzimi i vendburimeve të naftës dhe gazit” (L-35-508-19) Kl 13 – 64 orë

- Synimet e lëndës “Shfrytëzimi i vendburimeve të naftës dhe gazit”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Shfrytëzimi i vendburimeve të naftës dhe gazit”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të përzgjedhë mënyrat e shfrytëzimit të vendburimeve të naftës;
- Të organizojë format e monitorimit dhe treguesit e shfrytëzimit të vendburimeve;
- Të monitorojë ecurinë e treguesve të shfrytëzimit të puseve, të debitit, presionit dhe sasisë së ujit apo të rërës në fluid;
- Të organizojë të gjithë kapacitetet për të bërë të mundur rritjen e koeficientit të naftënxjerrjes me një shfrytëzim optimal të vendburimit;
- Të interpretojë planin e zhvillimit të vendburimit dhe treguesit e përpunimit;
- Të menaxhojë së bashku me inxhinieret punët për të përgatitur raportin për mos ndotjen e vendit të punës;
- Të kryejë detyrat e tij si teknik për praninë në vendin e punës të ekipit/brigadës, evidentimin e mirëmbajtjes periodike dhe kapitale të pajisjeve të puseve dhe punimeve të kryera në sipërfaqe, në trungun e pusit, në fund të pusit, në zonën pranë fundore dhe në shtresë;
- Të ruajë e të mirëmbajë librin (biografinë) e pusit nga fillimi i procesit të shpimit deri në përfundim të shfrytëzimit të pusit (deri kur abandonohet apo kalon në ruajtje);
- Të mirëmbajë kullat, agregatët, pajisjet sipërfaqësore e nëntokësore duke evidentuar dhe regjistruar gjendjen dhe masat për riparimin ose zëvendësimin e tyre.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Shfrytëzimi i vendburimeve të naftës dhe gazit” klasa 13- 64 orë

Tema 1	-Shfrytëzimi i vendburimeve të naftës me errupsion natyror. Organizimi i punimeve, skema, pajisjet, sistemi i grumbullimit, gazndarja dhe transporti i fluideve. Skema e transportit nga pusi në uzinat e përpunimit. Monitorimi i proceseve.	4 orë
---------------	---	-------

Tema 2	-Skema, pajisjet, sistemi i grumbullimit, ndarjes dhe transportit të naftës e gazit nga puset në shfrytëzimin e vendburimeve të naftës me errupsion artificial në uzinat e përpunimit. Monitorimi i proceseve.	4 orë
Tema 3	-Shfrytëzimi i vendburimeve të naftës me pompa thellësie. Organizimi i punimeve, skemat e shfrytëzimit. Menaxhimi i punimeve nxjerrjes së naftës. Pajisjet, lëkundësit, pompat e thellësisë. Monitorimi i proceseve.	4 orë
Tema 4	-Monitorimi i ecurisë së treguesve të shfrytëzimit të puseve, të debitit, presionit dhe sasisë së ujit apo të rërës në fluid;	3 orë
Tema 5	-Planifikimi i proceseve dhe operacioneve të remontit dhe të mirëmbajtjes së puseve për të minimizuar ndalesat e puseve duke organizuar gjithë kapacitetet për të rritur koeficientin e shfrytëzimit të puseve.	4 orë
Tema 6	-Mirëmbajtja (remonti) e zakonshme dhe kapitale e puseve. Organizimi i punimeve të kryera në sipërfaqe, në trungun e pusit dhe në fund të pusit.	4 orë
Tema 7	-Planifikimi i mirëmbajtjes së kullës, agregatëve, pajisjet sipërfaqësore e nëntokësore duke evidentuar dhe regjistruar gjendjen dhe masat për riparimin ose zëvendësimin e tyre.	4 orë
Tema 8	-Organizimi i punimeve/i proceseve që kryhen në kantier (vëndburim). Detyrat individuale dhe kolektive. Veprimet dhe përgjegjësitë.	2 orë
Tema 9	-Evidentimi i proceseve të kryera në pus, në librin (biografinë) e pusit nga fillimi i procesit të shpimit deri në përfundim të shfrytëzimit dhe kalimit të pusit në konservim.	2 orë
Tema 10	-Planifikimi i punimeve të stimulimit të puseve në zonën pranëfundore në pus. Përpilimi i planit dhe kompleksi i të dhënave që evidentohen.	3 orë
Tema 11	-Skemat e kryerjes së proceseve të stimulimit. Kryerja dhe monitorimi i proceseve.	3 orë
Tema 12	-Planifikimi i punimeve të izolimit të puseve në zonën pranëfundore në pus. Përpilimi i planit dhe kompleksi i të dhënave që evidentohen. Skemat e realizimit të proceseve.	3 orë
Tema 13	-Përforcimet, veçoritë dhe realizimi i tyre për forcimin e zonës pranëfundore. Monitorimi i procesit.	4 orë
Tema 14	-Metodat e veprimit në shtresë. Injektimi i ujit. Realizimi i procesit, kontrolli dhe monitorimi.	4 orë
Tema 15	-Injektimi i avullit. Gjeneratori i avullit. Realizimi i procesit, kontrolli dhe monitorimi.	4 orë
Tema 16	-Djegia nëntokësore. Realizimi i procesit, ndezja e shtresës, injektimi i ajrit. Kontrolli dhe monitorimi.	4 orë
Tema 17	-Injektimi i polimerëve. Realizimi i procesit, reagentët dhe tretësirat. Kontrolli dhe monitorimi.	4 ore
Tema 18	-Ndotjet sipërfaqësore gjatë proceseve teknologjike të nxjerrjes së naftës. Parandalimi apo mënjanimi i ndotjeve.	2 orë
Tema 19	Strategjia e zhvillimit të vendburimit dhe treguesit e përpunimit;	2 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Montimi i sondës së shpimit”

Drejtimi: Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi	MONTIMI I SONDËS SË SHPIMIT	M-35-1572-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprimtari praktike në organizimin e punimeve në procesin e montimit të një sonde shpimi	
Kohëzgjatja e modulit	48 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.12 në një nga profilet e niv. III të KSHK, të drejtimit mësimor “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi asiston në parapërgatitjen e montimit të sondës së shpimit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë sheshin e shpimit të pusit.- të përgatisë skicat për planvendosjen e bazamenteve.- të drejtojë punimet për hapjen e themeleve për çimentimin e bazamenteve.- të drejtojë punimet për përgatitjen e bazamenteve për montimin e këmbëve të kullës- të drejtojë punimet për përgatitjen e bazamenteve për montimin e motorëve të sondës.- të drejtojë punimet për përgatitjen e bazamenteve për montimin e pompave të shpimit.- të drejtojë punimet për përgatitjen e bazamentit për montimin e arganellos së shpimit.- të drejtojë punimet për përgatitjen e bazamenteve për montimin e paisjeve të pastrimit e qarkullimit të lëngut larës- të drejtojë punimet për përgatitjen e bazamenteve për montimin e magazinës së reagentëve kimikë.- të drejtojë punimet për përgatitjen e bazamenteve për montimin e zyrave dhe laboratorëve të pusit.- të drejtojë punimet për hapjen dhe izolimin e gropës në tokë për rezervimin e lëngut larës- të zbatojë rregullat sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri.- të mirëmbajë pastër vendin e punës. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.	

RM 2 Nxënësi asiston në montimin e sondës së shpimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të montojë arganellon dhe paisjet energjitike.
- të montojë kullën e shpimit.
- të montojë bazamentin e sondës dhe shkallët metalike.
- të montojë bazën mbështetëse të tubave të shpimit
- të montojë pompat e lëngut larës.
- të montojë pajisjet e sistemit të pastrimit dhe të qarkullimit të lëngut larës.
- të montojë sistemin e ulje-ngritjeve të instrumentit të shpimit.
- të montojë bazamentin e tubave dhe planin rrëshqitës në sondë
- të montojë kyçet e mbërthim zbërthimit të instrumentit të shpimit.
- të montojë litarin e arganellos së shpimit.
- të montojë aparatën e treguesit të peshës (drillometrin) të shpimit.
- të montojë magazinën e reagentëve kimikë.
- të montojë zyrat dhe laboratorët e pusit.
- të montojë paisje të tjera të sondës së shpimit.
- të përgatisë fillimin e shpimit të pusit.
- të zbatojë rregullat sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri.
- të mirëmbajë pastër vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në kantier (sondë), në kohën e montimit të një sonde shpimi. Në kushtet kur koha e praktikës nuk korespondon me kohën e montimit, atëherë praktika mund të kryhet në një sondë shpimi në kohën kur ajo është në aktivitet shpimi dhe instruktori demonstroi pranë sondës të gjitha veprimet praktike që kryhen për montimin e sondës.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli.
- Gjithashtu ata duhet të angazhohen në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve që përdoren në proceset e montimit të sondës së shpimit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Kantier (sondë), në kohën e montimit të një sonde shpimi
 - Komplet i mjeteve, veglave dhe pajisjeve për montimin e sondës;
 - Manuale, materiale udhëzuese, dokumentacion teknik në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Mbikqyrja e procesit të shpimit të pusit”

Drejtimi: Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	MBIKQYRJA E PROCESIT TË SHPIMIT TË PUSIT	M-35-1573-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprimtari praktike në procesin e shpimit të puseve, në zbërthimin e projektit teknologjik të shpimit të pusit dhe në organizimin dhe kryerjen e punimeve në sondën e shpimit gjatë procesit të shpimit të pusit	
Kohëzgjatja e modulit	48 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.12 në një nga profilet e niv.III të KSHK, të drejtimit mësimor “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi asiston në kryerjen e veprimeve praktike në shpimin e pusit Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të zbërthejë projektin e shpimit të pusit;- të kryejë përgatitjet e nevojshme për fillimin e shpimit të pusit;- të përgatisë lëngun larës për fillimin e shpimit të pusit,- të përgatisë paisjet e nevojshme për fillimin e shpimit të pusit;- të përgatisë dhe të vendosë Pipën;- të përgatisë dhe të vendosë Çibukun;- të hapë vrimën e shtrembër;- të zgjedhë dhe të mbërthejë daltën për shpimin e konduktorit;- të zbatojë regjimin e përshtatshëm për shpimin e pusit;- të përcaktojë vlerën e një linje në aparatit e matjes së peshës (drillometër);- të shpojë trungun e pusit për kollonën e konduktorit;- të zbatojë regjimin e shpimit për kollonën e konduktorit;- të përgatisë tubat e rrethimit dhe t'i rreshtojë ato në urën e tubave sipas rradhës së uljes në pus;- të përgatisë trungun e pusit për uljen e kollonës së konduktorit;- të realizojë uljen në pus të kollonës së konduktorit,- të realizojë çimentimin e kollonës së konduktorit;- të montojë preventorët;- të kryejë prova teknike për të provuar hermeticitetin dhe funksionimin e preventorëve;- të bëjë zgjedhjen dhe mbërthimin e daltës për shpimin e	

- trungut të pusit për kollonën e parë teknike;
- të zbatojë regjimin e shpimit për shpimin e trungut të pusit për kollonën teknike;
- të kryejë shpimin e trungut të pusit për uljen e kollonës teknike;
- të monitorojë ecurinë e shpimit të trungut të pusit në përputhje me projektin e shpimit të pusit;
- të përgatisë trungun e pusit për uljen e kollonës pasardhëse;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
- të zbatojë rregullat sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri.
- të mirëmbajë pastër vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi asiston në kryerjen e veprimeve praktike për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e lëngut larës

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë përbërësit e lëngut larës;
- të identifikojë parametrat e lëngut larës;
- të kryejë matjen e parametrave të lëngut larës;
- të vlerësojë përpunimin kimik të lëngut larës;
- të kryejë procedurat e përpunimit kimik të lëngut larës;
- të përgatisë lëngun larës me parametra të caktuar;
- të kryejë llogaritje për rëndimin e lëngut larës;
- të kryejë procedurat e rëndimit të lëngut larës;
- të procedojë për pastrimin e lëngut larës nga shllami;
- të identifikojë paisjet e pastrimit të lëngut larës;
- të realizojë në pus ndryshimin e tipit dhe parametrave të lëngut larës;
- të identifikojë humbjet e presionit në sistemin e qarkullimit të lëngut larës;
- të vlerësojë humbjet e presionit në sistemin e qarkullimit të lëngut larës;
- të vlerësojë luhatjet e presionit në procesin e shpimit të pusit;
- të identifikojë informacionin që merret nga lëngu larës gjatë shpimit të pusit;
- të bëjë vlerësimin praktik të informacionit që merret nga lëngu larës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në kantjer (sondë), gjatë procesit të shpimit të një pushi.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli.
- Gjithashtu ata duhet të angazhohen në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve që përdoren në procesin e shpimit të pusit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Kantier (sondë), në kohën e montimit të një sonde shpimi
 - Kompleti i mjeteve, veglave dhe pajisjeve për montimin e sondës; Manuale, materiale udhëzuese, dokumentacion teknik në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul;
-

3. Moduli “Organizimi i proceseve të nxjerrjes së naftës dhe gazit”

Drejtimi: “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	ORGANIZIMI I PROCESVEVE TË NXJERRJES SË NAFTËS DHE GAZIT	M-35-1574-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprimtari praktike në organizimin e punimeve në procesin e nxjerrjes së naftës dhe gazit	
Kohëzgjatja e modulit	48 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.12 në një nga profilet e niv. III të drejtimit mësimor “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi asiston në kryerjen e veprimeve praktike në venien në shfytëzim të pusit/eve të nxjerrjes së naftës dhe gazit Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- Të përzgjedhë tubot e prodhimit, purtekat dhe pajisjet e grykës së pusit.- Të kryejë/drejtojë operacionet e uljes së tubove, purtekave dhe pompës së thellësisë- Të llogarisë karakteristikat e lëkundësit (S, n) dhe të vendosë hapin dhe numrin e rrotullimeve (S,n), për debitin e dhënë.- Të drejtojë punimet e mbylljes së pusit dhe të monitorojë sigurinë e lëkundësit, të sistemit elektrik dhe sigurinë e territorit rreth pusit.- Të mbikqyrë me kujdes të gjitha pajisjet dhe mekanizmat (kulla dhe organellon) gjatë ulje-ngritjes së tubove, purtekave dhe pompës.- Të zbatojë rregullat sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri.- Të mirëmbajë pastër vendin e punës. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RM 2 Nxënësi asiston në kryerjen e veprimeve praktike në operacionet e nxjerrjes së naftës dhe gazit nga pusi. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- Të vendosë gati për punë pusin e nxjerrjes së naftës.- Të kryejë lëshimin e pusit nëpërmjet sistemit elektrik.- Të kryejë monitorimin fillestar të pompës së thellësisë nëpërmjet dinamometrit.	

- Të kontrollojë ardhjen e fluideve dhe të kryejë matjen e debiteve të fluideve në depot individuale.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në kantjer, në grykë të pusit dhe në grupin e grumbullimit, në kohën e vënies në punë të pusit të nxjerrjes së naftës në shfrytezimin me pompë thellësie.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli.
- Gjithashtu ata duhet të angazhohen në përdorimin e mjeteve levizëse dhe pajisjeve që përdoren në operacionet e nxjerrjes së naftës e gazit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Kantier (sondë), në kohën e montimit të një sonde shpimi
 - Kompleti i mjeteve, veglave dhe pajisjeve për montimin e sondës; Manuale, materiale udhëzuese, dokumentacion teknik në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul;
-

4. Moduli “Drejtimi i operacioneve të grumbullimit dhe transportit të naftës dhe gazit”

Drejtimi: “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	DREJTIMI I OPERACIONEVE TË GRUMBULLIMIT DHE TRANSPORTIT TË NAFTËS DHE GAZIT	M-35-1575-20
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprimtari praktike në procesin e grumbullimit dhe transportit të naftës e gazit, në zbërthimin e skemave të grumbullimit dhe transportit të naftës, në tubacione dhe magjistrale, në identifikimin e stacioneve të pompimit dhe të kompresorëve në rrugën e transportit të naftës nga grupet e grumbullimit, në uzinat e përpunimit apo në konsumatorë të tjerë.	
Kohëzgjatja e modulit	48 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kl.12 në një nga profilet e niv. III të KSHK, të drejtimit mësimor “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi asiston në kryerjen e veprimeve praktike në grumbullimin e fluideve (të naftës, gazit dhe ujit). Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- Të zbërthejë skemat dhe nyjet e ndryshme të projektit të grumbullimit të naftës- Të zgjedhë dhe të përgatisë linjat e transportit të fluideve dhe magjistralin në depot individuale, në depot e grumbullimit të naftës në grup dhe në sektor.- Të kryejë monitorimin e prodhimit të fluideve, duke matur debitin e naftës, të gazit dhe presionin e tyre.- Të kontrollojë nyjet ndërmjetëse si gazndarësit, valvolat e frymëmarrjes dhe të kryejë operacionet e mbushjes dhe të shkarkimit të tyre në varësi të debitit të grumbulluar/prodhuar.- Të kryejë trajtimin paraprak të fluideve, ndarjen e nafës nga gazi, rëra dhe uji.- Të kryejë manovra të veçanta tek stacioni i grumbullimit të naftës, në depot e grupit, të sektorit dhe stacionit qendror të grumbullimit.- Të kryejë trajtimin e mëtejshëm të naftës në stacionin qendror të grumbullimit në vendburim me metoda termike dhe kimike.- Të organizojë procesin e ngrohjes së naftës për trajtimin termik të naftës.- Të përzgjedhë reagentët kimikë në stacionin qendror para dërgimit në uzinat e përpunimit.	

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Nxënësi asiston në kryerjen e veprimeve praktike për transportin e naftës nga pusi i prodhimit në stacionin qëndror para dërgimit në uzinën e përpunimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të zbërthejë skemat dhe nyjet e ndryshme të projektit të transportit të naftës.
- Të identifikojë nyjet e bashkimit të tubacioneve, të saraqineskave apo të valvolave të ndryshme dhe funksionimin e tyre.
- Të kontrollojë nyjet ndërmjetëse si gazndarësit, valvolat e frymëmarrjes dhe të kryejë operacionet e mbushjes dhe të shkarkimit të tyre në varësi të debitit të grumbulluar/prodhuar.
- Të zgjedhë linjat e transportit të fluideve dhe magjistralin në depot individuale, në depot e grumbullimit të naftës në grup dhe në sektor.
- Të vendosë pompën e shtytjes së naftës në funksionim.
- Të kryejë riparimet dhe mirëmbajtjen e pompave.
- Të monitorojë presionet gjatë pompimit të naftës dhe të marrë masa për mënjanimin e mbi presionit të lejuar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

- Ky modul duhet të trajtohet në grupet e grumbullimit dhe transportit të naftës në vendburim.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli.
- Gjithashtu ata duhet të angazhohen në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të kontrollit që përdoren gjatë grumbullimit dhe transportit të naftës e gazit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Kantier (sondë), në kohën e montimit të një sonde shpimi
 - Kompleti i mjeteve, veglave dhe pajisjeve për montimin e sondës; Manuale, materiale udhëzuese, dokumentacion teknik në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-